



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE

MBI KRITERET, RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR DELEGIMIN E DISA FUNKSIONEVE NGA SHOQËRITË E SIGURIMIT

Miraturar me vendimin e Bordit nr. 120, datë 26.11.2015

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kriterëve, rregullave dhe procedurave për delegimin nga shoqëritë e sigurimit të disa funksioneve.

Neni 2 Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe të nenit 53, pika 5, e ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”.

Neni 3 Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Autoriteti” është Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare;

- b) "Delegimi" është transferimi i një ose disa funksioneve të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit të një person juridik nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate.
- c) "Funksione të deleguara" janë funksionet që mund të delegohen nga shoqëria e sigurimit tek një person tjetër të cilat përkatësisht janë:
 - d) i) trajtimi dhe vlerësimi i dëmeve;
 - ii) shërbimet aktuariale;
 - iii) shërbimet e promovimit dhe marketingut;
 - iv) shërbimet e IT-së;
 - v) mbajtja e kontabilitetit;
 - vi) administrimi i aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike dhe matematike.
- ç) "Ligi" është ligji nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit".
- d) "Person i deleguar" është personi juridik që do të ushtrojë funksionet e deleguara.

Neni 4

Kriteret për delegimin e funksioneve

1. Personi i deleguar, të cilit do t'i delegohen funksionet e shoqërisë së sigurimit, duhet të jetë i aftë dhe i përshtatshëm për të kryer këto funksione, njësoj sikur ato të kryheshin nga shoqëria e sigurimit.
2. Funksionet e deleguara duhet të ushtrohen në mënyrë të tillë që të mos rrezikohet aftësia, stabiliteti, vazhdimësia dhe cilësia e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit.
3. Delegimi i funksioneve, në asnjë rast, nuk shmang përgjegjësitë e organeve drejtuese të shoqërisë së sigurimit.

Neni 5

Rregullat e shoqërisë për delegimin e funksioneve

1. Shoqëria e sigurimit harton dhe miraton politika për identifikimin e funksioneve që do të delegohen, duke vlerësuar ndikimin që do të ketë delegimi në veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit.
2. Shoqëria e sigurimit studion tregun dhe përcakton tarifat e delegimit.
3. Shoqëria e sigurimit harton dhe miraton procedurat për delegimin e funksioneve të shoqërisë së sigurimit.

4. Shoqëria e sigurimit përcakton kërkesat e përgjithshme dhe specifike të përzgjedhjes së personit që do të ushtrojë funksionet e deleguara.
5. Shoqëria e sigurimit harton dhe miraton rregulla për raportimin nga ana e personit të deleguar si dhe për monitorimin prej saj të personit të deleguar.

Neni 6

Dokumentacioni për delegimin e funksioneve

Shoqëria e sigurimit njofton me shkrim dhe depoziton në Autoritet kërkesën për miratimin e delegimit të funksioneve tek një person i deleguar, e cila shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

- a) vendimin e këshillit të administrimit/mbikëqyrës për delegimin e funksioneve;
- b) përshkrimin e funksioneve që shoqëria e sigurimit kërkon të delegojë, si dhe kushtet që duhet të përmbushë personi potencial i deleguar për kryerjen e ketyre funksioneve, si dhe kohëzgjatjen e delegimit;
- c) të dhëna mbi personin potencial të deleguar: emrin, vërtetimin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, si dhe të dhëna të tjera në rastin e personave potencial të deleguar nga një vend i huaj: adresën, numrin e telefonit, numrin e faksit, adresën e e-mailit, faqen zyrtare, emrin, mbiemrin dhe detaje të kontaktimit të personit të autorizuar për përfaqësim të personit potencial të deleguar;
- ç) rezultatet e analizave dhe vlerësimeve të kryera nga shoqëria e sigurimit sipas përcaktimeve të pikës 2 të nenit 7 të kësaj rregulloreje;
- d) kontrata të ngjashme, nëse ka;
- dh) eksperiencia të mëparshme të veprimtarisë.

Neni 7

Përzgjedhja e personit juridik që do të ushtrojë funksionet e deleguara

1. Shoqëria e sigurimit gjatë delegimit të një prej funksioneve të deleguara, garanton që përzgjedhja e personit të deleguar:
 - a) nuk cënon rezultatet financiare dhe stabilitetin e shoqërisë dhe vazhdimësinë e aktiviteteve të saj;
 - b) nuk cënon cilësinë e administrimit dhe vendim marrjes së shoqërisë së sigurimit;
 - c) nuk cënon aftësinë e shoqërisë për t'ju ofruar të siguruarve një shërbim të vazhdueshëm;
 - ç) nuk krijon një rritje të pajustificuar të rreziqeve operationale.
2. Shoqëria e sigurimit përpara përzgjedhjes së personit të deleguar:

- a) kryen një analizë të detajuar të aftësisë dhe kapacitetit të personit potencial të deleguar;
- b) sigurohet që personi potencial i deleguar ka marrë të gjitha masat e nevojshme për shmangien e konfliktit të interesit;

Neni 8

Kontrata e delegimit të funksioneve

1. Përveç sa është parashikuar në ligj kontrata e delegimit të funksioneve ndërmjet shoqërisë së sigurimit dhe personit të deleguar duhet të përmbajë sa më poshtë:
 - a) të drejtat dhe detyrimet e palëve;
 - b) angazhimin e personit të deleguar për të kryer veprimtarinë e tij në përputhje me legjislacionin në fuqi, kërkesat rregullatore si dhe politikat e miratuara nga shoqëria e sigurimit, dhe për të bashkëpunuar me Autoritetin për sa i përket funksioneve të deleguara;
 - c) detyrimin e personit të deleguar për të informuar menjëherë shoqërinë për çdo fakt që mund të ketë një ndikim të rëndësishëm në aftësinë e tij për të kryer në mënyrë efikase dhe efektive veprimtarinë e tij sipas kërkesave ligjore në fuqi;
 - ç) një periudhë njoftimi për përfundimin e kontratës nga ana e personit të deleguar, e cila është e mjaftueshme për shoqërinë e sigurimit të gjejë një zgjidhje alternative;
 - d) të drejtën e shoqërisë së sigurimit për t'u informuar në lidhje me mbarëvajtjen e funksioneve të deleguara nga personi i deleguar, si dhe të drejtën e shoqërisë së sigurimit për të hartuar dhe miratuar udhëzime të përgjithshme apo të veçanta në lidhje me kryerjen e funksioneve të deleguara;
 - dh) ruajtjen e konfidencialitetit nga ana e personit të deleguar të të dhënave që lidhen me shoqërinë e sigurimit dhe me të siguruarin;
 - e) të drejtën e shoqërisë së sigurimit për t'u tërhequr nga kontrata, nëse kjo e fundit kërkohet nga Autoriteti për shkaqe të mosrespektimit të kritereve ligjore.
2. Kontrata e delegimit të funksioneve bëhet me shkrim dhe personi i deleguar që do të ushtrojë funksionet e deleguara nuk mund ta nënkontraktojë atë tek të tjerë.
3. Në rastin e delegimit të funksionit të mbajtjes së kontabilitetit, shoqëria e sigurimit duhet të sigurohet që në kontratë të përcaktohen:
 - a) objektivat, metodat dhe frekuenca e hartimit të bilanceve;
 - b) procedurat dhe shpeshësia e raportimit në organet drejtuese të shoqërisë.
 - c) si dhe në përputhje me legjislacionin për mbajtjen e kontabilitetit.

Neni 9

Miratimi ose refuzimi nga Autoriteti i delegimit të funksioneve

1. Autoriteti, shqyrton dhe merr vendim brenda 2 muajve, duke miratuar ose refuzuar, delegimin e funksioneve në përputhje me kërkesat e nenit 54 të ligjit.
2. Autoriteti shqyrton kërkesën dhe dokumentacionin e paraqitur dhe kur vëren mangësi ia kthen shoqërisë. Afati 2 muaj fillon me riparaqitjen e tyre.
3. Autoriteti pas marrjes së vendimit për miratim apo refuzim njofton shoqërinë e sigurimit për marrjen e këtij vendimi. Në rast refuzimi, Autoriteti i bën të ditur shoqërisë së sigurimit edhe arsyet e këtij refuzimi.

Neni 10

Monitorimi nga shoqëria e sigurimit e funksioneve të deleguara

1. Shoqëria e sigurimit monitoron në mënyrë të vazhdueshme funksionet që delegohen, në veçanti përputhshmërinë me kriteret ligjore.

Neni 11

Mbikëqyrja nga Autoriteti

Autoriteti nëse gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes së shoqërisë së sigurimit/personit të deleguar konstaton ekzistencën e vënies në rrezik të interesave të të siguruarve apo/dhe mospërmbushjen e kërkesave të ligjit ose/dhe të kësaj rregulloreje, Autoriteti urdhëron shoqërinë e sigurimit të ndryshojë apo të përfundojë delegimin e funksioneve.

Neni 12

Hyrja në Fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.